



Pranuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	01.07.2022	2	viti god. year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3861/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.503/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.503/2022 të datës 06.06.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike " Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 01.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.503/2022 e datës 06.06.2022 e parashtruar nga ankuesja Vlora Bejta-Hyseni.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Mitrovicës, me datë 06.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3286/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër komunës së Mitrovicës lidhur me harmonizimin e koeficientit nga pesë (5) në shtatë (7).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës, ndërsa kjo e fundit më datë 22.06.2022 ka përcjell në Këshill përgjigjen me numër protokoll 3642/2022 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3286/2022 të datës 06.06.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; e-mail zyrtar i datës 24.06.2022; e-mail zyrtar i datës 24.06.2022; Kërkesë me nr. 01.121.1069 i datës 15.01.2013; Vendim mbi transferimin e përhershëm të nëpunësit civil me Nr. 01/121-1069/2 i datës 27.02.2013; Akt Emërim i V.B. me nr. 01.112.25547 i datës 02.10.2013; e-mail zyrtar i datës 24.06.2022; Kontratë e Punës e V.B. i datës 06.09.2011; Diplomë e V.B.H. me Nr.206/15 i datës 25.02.2015; Vendim i datës 02.12.2015; Konfirmim financiar i mjeteve nga pozicioni i pagave i datës 03.12.2015; Kërkesë e datës 25.03.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 13.05.2022; Përshkrimi i punës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i V.B. i datës 30.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i V.B. i datës 15.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i V.B. i datës 31.01.2022; Vendim për formimin e komisionit për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale i datës 03.02.2021; Vendim për formimin e komisionit për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale i datës 18.01.2022; Vendim i datës 04.03.2022; Lista e pagave e datës 01.04.2022 deri 30.04.2022; Lista e pagave e datës 01.08.2021 deri 31.08.2021; e-mail zyrtar i datës 06.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 09.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 22.06.2022; Shkresë për sqarime shtesë e datës 17.06.2022; Pliko me nr. R2100324 i datës 20.06.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse:*

Duke u bazuar në Kontratën e Punës së datës 06.09.2011, rezulton se ankuesja ka qenë e sistemuar në pozitën "Zyrtar Administrativ", në Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pylltarisë, me koeficient pesë (5) të pagës. Kryetari i Komunës së Mitrovicës me Vendimin me numër protokollit Nr. 01/121-1069/2 të datës 27.02.2013, përmes transferimit të përhershëm ka bërë sistemimin e ankueses në pozitën e punës "Zyrtar për Leje Mjedisore Komunale" pranë Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pylltarisë, duke përcaktuar se transferimi dhe paga e nëpunësit do të jetë sipas rregullave për shërbimin civil.

Nga shkresat e lëndës që kemi pasur në shqyrtim me rastin e trajtimit të ankesës, Kolegji nuk ka gjetur ndonjë shkresë me të cilën ankuesja ka parashtruar kërkesë tek Komuna e Mitrovicës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës për pozitën "Zyrtar për Leje Mjedisore Komunale", pasi ka marrë vendimin për sistemim të përhershëm në këtë pozitë.

Ankuesja më datë 06.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër komunës së Mitrovicës lidhur me harmonizimin e koeficientit nga pesë (5) në shtatë (7), duke propozuar që Këshilli të detyroj Komunën e Mitrovicës që të ndërmarrë veprimet konform ligjeve në fuqi dhe t'ia njeh të drejtën lidhur me harmonizim të koeficientit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankueses që ka të bëjë me shkresat e datës 25/03/2022 nga Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve drejtuar Zyrës së Personelit dhe përgjigjes nga Menaxheri i Personelit të datës

13/05/2022, por të cilat shkresa kolegji konstaton se nuk lidhen me komunikim të ankueses në lidhje me këtë çështje që është objekt i kësaj ankese dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë veprim procedural-administrativë që mund të argumentohet fakti se veprimet e ankueses janë në afate ligjore sa i përket kësaj çështje dhe poashtu në përmbajtje të përgjigjes në kërkesë të datës 13/05/2022 është konfirmuar fakti se ankuesja nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor dhe në afate ligjore sa i përket realizimit të kësaj kërkesë që është objekt i kësaj ankese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka konstatuar se në kohën e transferimit të përhershëm të ankueses me Vendimin me numër protokoll Nr. 01/121-1069/2 të datës 27.02.2013, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë nenin 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës".* Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë se ankuesja në rast të pakënaqësisë me Vendimin me numër protokoll Nr. 01/121-1069/2 të datës 27.02.2013 sipas të cilit ankueses nuk i është njohur koeficienti i pagës për pozitën e transferuar me ndonjë koeficient tjetër nga ai që e ka pasur më herët, dhe kjo është vërtetuar edhe përmes aktemrimit të datës 30/08/2013 ndërsa e njëjta ka mundur të ushtroj ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, andaj meqenëse ankuesja deri me datë 06.06.2022 nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik kundër Vendimit për transferim të përhershëm në pozitën "Zyrtar për Leje Mjedisore Komunale", në të cilin vendim nuk ishte precizuar koeficienti saktë dhe më tutje kishte nënshkruar edhe aktemrimin më datë 30/08/2013 me koeficientë 5 pa ndonjë ndryshim të koeficientit nga ai që kishte pasur më herët dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankesa e ankueses A.nr.503/2022 e datës 06.06.2022 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pula është njoftuar për aktin administrativ"*.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.503/2022, datë 01/07/2022

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankueses,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

